

		REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINA SUVA REKA - MUNICIPALITY OF SUHAREKË			
Data: 03/08/2026		03-08-2026			
Për: Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës		REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit Përnd. Broj Member Shënjë Përlig Appendix Vlera Vrednost Value 01 0/6 36465 A			
Nga: Armend Krasniqi, Kryesues i Komomisionit					
Nga: Kryesues Komunale për zhvillimin e procedurave dhe shqyrtimin e ofertave për dhenjen ne shfrytezim afatgjat te pronës komunale					
Lënda: Vlerësimi dhe Rekomandimi i fituesve					

Në bazë të Vendimit nr. 01-016-29991, të datës 30.05.2024, të Kuvendit të Komunës së Suharekës, për emërimin e Komisionit për Zbatimin e Procedurave dhe Vlerësimin e Ofertave për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Komisioni përgatiti këtë:

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Për vlerësimin e ofertave në Konkurrim të Hapur nr. 01-016-29991 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, si dhe të vendimit për emërimin e Komisionit për Zbatimin e Procedurave dhe Vlerësimin e Ofertave, Komisioni paraqet këtë raport përfundimtar lidhur me procedurën e zhvilluar sipas Konkurrimit të Hapur nr. 01-016-29991.

HISTORIKU I PROCEDURËS

Komuna e Suharekës ka shpallur Konkurrim të Hapur nr. 01-016-29991 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale.

Gjatë zhvillimit të procedurës, më datë 09.06.2025, pas shpalljes së zgjedhjeve lokale nga Presidentja e Republikës së Kosovës, procedurat administrative lidhur me këtë ankand janë pezulluar deri në konstituimin e organeve të reja komunale.

Pas konstituimit të organeve të reja komunale dhe emërimit të Komisionit të ri për Zbatimin e Procedurave dhe Vlerësimin e Ofertave, Komisioni ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së zhvilluar deri në momentin e pezullimit, ka verifikuar procesverbalet, dokumentacionin administrativ dhe ofertat e dorëzuara, si dhe ka konstatuar se procedurat paraprake janë zhvilluar në përputhje me kushtet e ankandit publik dhe legjislacionin në fuqi.

Sa i përket banesës me identifikues **O-72116046-56-2-13-0**, hyrja **H-2**, kati përdhes (NK), për të cilën nuk kishte pasur përfitues në procedurën paraprake, Komisioni ka iniciuar procedurë të re përmes shpalljes së një thirrjeje të re për konkurrim. Në thirrjen e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, prandaj procedura është përsëritur. Në thirrjen e dytë janë paraqitur dy ofertues, duke mundësuar vazhdimin e procedurës për dhënie në shfrytëzim në përputhje me kushtet e shpalljes publike.

VLERËSIMI I OFERTAVE

1. Banesa

Banesa në rrugën "**Brigada 123**", Suharekë, objekti **O-72116046-56-2-3-0**, hyrja **H-2**, kati **II**, sipas Sistemit të Unifikuar të Adresave, me sipërfaqe të përgjithshme **58.97 m²**, pronë shoqërore në emër të Komunës së Suharekës.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të pranuar, Komisioni konstatoi se ofertuesja **Halime Shala** është shpallur fituese me **100% të pikëve**, duke ofruar çmimin prej **1.00 € (një euro) për metër katror (m²) për muaj**, në përputhje me kushtet e përcaktuara në shpalljen publike.

2. Banesa

Banesa në rrugën "**Brigada 123**", Suharekë, objekti **O-72116046-56-2-7-0**, hyrja **H-2**, kati **III**, sipas Sistemit të Unifikuar të Adresave, me sipërfaqe të përgjithshme **58.97 m²**, pronë shoqërore në emër të Komunës së Suharekës.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të pranuar, Komisioni konstatoi se ofertuesja **Shkurte Tafaj** është shpallur fituese me **100% të pikëve**, duke ofruar çmimin prej **1.00 € (një euro) për metër katror (m²) për muaj**, në përputhje me kushtet e përcaktuara në shpalljen publike.

3. Banesa

Banesa në rrugën "**Brigada 123**", Suharekë, objekti **O-72116046-56-2-10-0**, hyrja **H-2**, kati **IV**, sipas Sistemit të Unifikuar të Adresave, me sipërfaqe të përgjithshme **58.97 m²**, pronë shoqërore në emër të Komunës së Suharekës.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të pranuar, Komisioni konstatoi se ofertuesi **Avdulla Krasniqi** është shpallur fitues me **100% të pikëve**, duke ofruar çmimin prej **1.00 € (një euro) për metër katror (m²) për muaj**, në përputhje me kushtet e përcaktuara në shpalljen publike.

4. Banesa

Banesa në rrugën "**Brigada 123**", Suharekë, objekti **O-72116046-56-2-13-0**, hyrja **H-2**, kati (NK), sipas Sistemit të Unifikuar të Adresave, me sipërfaqe të përgjithshme **58.97 m²**, pronë shoqërore në emër të Komunës së Suharekës.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të pranuara, Komisioni konstatoi se ofertuesja **Remzije Jupaj** është shpallur fituese me **100% të pikëve**, duke ofruar çmimin prej **1.00 € (një euro) për metër katror (m²) për muaj**, në përputhje me kushtet e përcaktuara në shpalljen publike.

REKOMANDIMI I KOMISIONIT

Duke u bazuar në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura, si dhe pas verifikimit të plotë të dokumentacionit të procedurës, Komisioni rekomandon:

1. Dhënien në shfrytëzim afatgjatë të banesës së lartcekur ofertueses **Shkurte Tafaj**.
2. Dhënien në shfrytëzim afatgjatë të banesës së lartcekur ofertueses **Halime Shala**.
3. Dhënien në shfrytëzim afatgjatë të banesës së lartcekur ofertuesit **Avdulla Krasniqi**.
4. Dhënien në shfrytëzim afatgjatë të banesës së lartcekur ofertueses **Remzije Jupaj**.

Komisioni vlerëson se ofertuesit e rekomanduar kanë përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në shpalljen publike dhe kanë paraqitur ofertat në përputhje me kushtet e përcaktuara, prandaj rekomandohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të banesave të lartcekura.

KONKLUZION

I propozohet Kryetarit të Komunës së Suharekës që ta shqyrtojë këtë raport dhe ta procedojë propozimin në Kuvendin e Komunës, me rekomandim që Kuvendi i Komunës të miratojë vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale të lartcekura në favor të ofertuesve të rekomanduar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kryesuesi i Komisionit

Armend Krasniqi





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /
Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : Komuna e Suharekës

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	501-2026
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	05.08.2026 - 10:21
Komuna / Opština / Municipality:	SUHAREKË / SUVA REKA / SUHAREKË
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	SUHAREKË / SUVA REKA / SUHAREKË

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afatizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Licni broj/broj postovanja ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Država državljanstva ili uknjiženja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment	Krijanar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
Komuna e Suharekës			/	600535209	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO			

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Ažurirano Updated
/		BRIGADA 123		

B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

[illegible]

